



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 20. 02. 2015, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Munguan: Qerim Bajrami, Ramush Haradinaj.

Me ftesë të Komisionit, në mbledhje ishte prezent ministri i Ministrisë së Diasporës, z. Valon Murati dhe Kushtrim Sheremeti, këshilltar i lartë politik.

Pjesëmarrës të tjerë: Saniye Berisha-OSBE; Xhavit Drenori –IPS Alumni Kosovë; Gurjeta Zeka-VV dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës, z. Valon Murati;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9 shkurt 2015;
4. Shqyrtimi i shkresës për formimin e grupeve të miqësisë;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës, z. Valon Murati

Enver Hoxhaj, fillimisht theksoi se ky takim është në interes të përbashkët, që të kemi qasje se çka në të vërtetë Kuvendi mund ta ndihmojë Ministrinë dhe çka Ministria mund ta ndihmojë diasporën, si fokus kryesor të punës së saj. Ai shtoi se është e nevojshme që Komisioni të njoftohet më shumë rreth gjendjes aktuale lidhur me të drejtat politike dhe sociale të diasporës, integrimin e diasporës, procesin e regjistrimit të diasporës, rreth ruajtjes së identitetit të diasporës, jetës kulturore dhe mësimi plotësues të diasporës. Kryetari Hoxhaj shprehu mendimin se të gjitha sfidat që i ka diaspora, nuk mund t'i adresojë vetëm Ministria e Diasporës dhe se duhet të ekzistojë një bashkëpunim me ministri të tjera, për çka pyeti se a kanë arritur që në këtë kohë të shkurtër të kultivohet një qasje ndër-sektoriale.

Për investimet e huaja direkte, tha se është folur shumë, por shumë pak janë marrë në konsideratë projektet konkrete se si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që janë në pronësi të diasporës, të investojnë në Republikën e Kosovës.

Valon Murati, theksoi se duke u bazuar në Ligjin për diasporën dhe mërgatën, është nxjerrë Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013 – 2018, e cila ka 4 objektiva kryesore: promovimin dhe avancimin e të drejtave politike dhe sociale të diasporës; ruajtjen e identitetit dhe fuqizimin e lidhjeve me diasporën; integrimin e pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë dhe lehtësimin e përfshirjes së diasporës në zhvillimin socio-ekonomik. Bëri të ditur se është rishikuar plani i punës, duke u harmonizuar me buxhetin e ndarë për ministrinë, njëkohësisht theksoi se duhet punuar ngushtë me ministri tjera, posaçërisht me ato të lëmit ekonomik, të kulturës dhe të arsimit.

Më pas, ai tha se ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën, bëhet përmes mësimi të gjuhës shqipe në diasporë dhe se është një prej objektivave më të rëndësishme të ministrisë.

Ministria e Diasporës, Ministria e Arsimit e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, kanë krijuar një dokument të përbashkët, me të cilin synohet trajtimi i gjuhës shqipe në mënyrë unike dhe në funksion të kësaj të nënshkruhet një marrëveshje në mes të dy shteteve. Ministri Murati theksoi nevojën që të punohet me qytetarët tanë në avancimin e të drejtave të tyre civile dhe politike, në mënyrë që t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë dhe resurset që vendet i ofrojnë dhe të bëhet ngritja e kapaciteteve të diasporës sonë. Ai në vazhdim njoftoi për angazhimet e ministrisë për qasje me shoqërinë civile dhe hapat që do të ndërmerren që diaspora të rrisë pjesëmarrjen në jetën civile dhe politike të vendit.

Ministri njoftoi se pjesë e Strategjisë së Ministrisë së Diasporës ka qenë edhe krijimi i një komisioni parlamentar për diasporën në Kuvendin e Kosovës, por ky propozim është tërhequr dhe është propozuar që dikasteri për diasporën, t'i shtohet njërit nga komisionet ekzistuese. Lidhur me regjistrimin e diasporës, tha se është menduar që në vitin 2016, të dilet me shifrat përfundimtare të regjistrimit. Lidhur me formimin e qendrave kulturore, tha se është formuar një grup pune, i cili ka për obligim që ta shohë statusin e tyre legal sesi duhet do të funksionojnë ato qendra jashtë, cili do të jetë raporti me ambasadat tona, cili do të jetë raporti me shtetet pritëse, si dhe të bëjnë prezantimin e kulturës sonë.

Ministri njoftoi se për realizim e objektivit për investimet e diasporës në Kosovë, janë krijuar 15 rrjete biznesi dhe se këtë vit do të krijohen edhe 4 apo 5 rrjete të tjera dhe do të punohet në konsolidimin e këtyre rrjeteve. Konsideron që integrimi i diasporës në vendin ku jetojnë është i rëndësishëm për Kosovën, pra sa më shumë që ata integrohen, aq më shumë do të mund të ndihmojnë dhe të jenë urë lidhëse mes atyre shteteve dhe vendit tonë. Njoftoi për vizitën fundit të tij në Austri, për fondin humanitar për ndërtimin e 100 shtëpive për Kosovën Lindore. Lidhur me aktivitetet e tij, njoftoi se është takuar me kryetarin e qytetit të Lincit dhe guvernatorin e Austrisë së Epërme, në Kroaci me ministrin e Arsimit, me zëvendësministrin e Kulturës, si dhe me drejtoreshën e Zyrës për Kroatët Jashtë Kroacisë, ku kanë biseduar për përvojat mes njëri- tjetrit dhe për integrimin e komunitetit shqiptar në Kroaci. Bëri të ditur se në Kroaci është themeluar rrjeti i të rinjve dhe studentëve për Kroacinë dhe për Slloveninë, i cili është në fazat fillestare të organizimit të tij.

Ministri Murati njoftoi edhe për aktivitetet dhe takimet që kishte pasur me komunitetin shqiptar në Londër dhe theksoi se diaspora jonë ka nevojë që zëri i saj të dëgjohet më shumë në Kuvend dhe që Kuvendi i Kosovës të jetë më shumë i përfshirë në trajtimin e problemeve të diasporës.

Teuta Rugova, falënderoi ministrin për raportimin e tij dhe pyeti nëse është menduar për krijimin e një kanali publik televiziv për diasporën.

Puhie Demaku, përkrah ministrin lidhur me amendamentimin e Ligjit për diasporën dhe mërgatën, posaçërisht neni 5 dhe 6, ku bëhet fjalë për fushëveprimin e qendrave kulturore. Sa i përket regjistrimit të diasporës, kërkoi të dijë se deri ku ka arritur ky proces dhe një vlerësim nga ana e ministrit për metodat që janë përdorur, për shkak të vërejtjeve të shumta në këtë proces.

Si Lëvizje Vetëvendosje tha se kemi pasur vërejtje edhe tek fushata sensibilizuese, sepse është përdorur media vendore për një audiencë në mërgatë, të cilët nuk kanë qasje në këto media. Më tej, shtroi pyetje lidhur me numrin e qytetarëve që kanë ikur nga Kosova gjatë muajve të fundit, për strategjinë e ministrisë, e cila ka qenë e gatshme dhe se çfarë mendohet të ndryshohet në këtë strategji konform aktualitetit. Deputetja Demaku, në vazhdim, pyeti lidhur me krijimin e kushteve për mërgimtarët që të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për votim, lidhur me shtetësinë e dyfishtë apo të mungesës së saj, se a ka ndonjë mekanizëm që ua mundëson mërgimtarëve të Kosovës, të cilët nuk e pranojnë shtetësinë e dyfishtë, që të marrin pjesë në votim në Kosovë, lidhur me Kartonin e Gjellbër dhe lidhur me buxhetin e Ministrisë së Diasporës. Ajo pyeti edhe për një projekt kapital nga buxheti i vitit 2013, në vlerë prej 250 000 euro për renovimin e një objekti në Lupç, se për çfarë objekti bëhet fjalë dhe se a ka filluar ky renovim, pasi që nuk parashihet tek projekt shpenzimet kapitale.

Blerta Deliu-Kodra, tha se ideja e inkorporimit të dikasterit të diasporës në Komisionin për Punë të Jashtme, është ide e qëlluar dhe duhet të trajtohet me seriozitet. Lidhur me regjistrimin e diasporës pyeti se a ka ministria një data-bazë të organizatave dhe personaliteteve më të shquara, me të cilët është e rëndësishme që të kemi raporte të mira si shtet.

E përkrahu idenë e krijimit të urave ndërmjet juristëve, ekonomistëve, e artistëve dhe të zhvillimit të tyre dhe kërkoi të dijë përshtypjen e shteteve që i ka vizituar ministri rreth migrimit ilegal dhe se a kanë strategji për të kthyerit.

Zafir Berisha, theksoi se është i befasuar për të mirë me qasjen që ka Ministria e Diasporës për pjesën e shoqërisë që është jashtë vendit e që është tepër e rëndësishme. Pyeti Ministrin Murati se a e llogarisin shpërnguljen masive të fundit si diasporë dhe për raportet e këtyre ditëve të fundit, se këta qytetarë do të kthehen në mënyrë kolektive.

Elmi Reçica, falënderoi ministrin Murati për raportimin e frytshëm dhe për angazhimin e punën që është duke e bërë Ministria e Diasporës. Kërkoi të informohet sesi është e organizuar mërgata dhe sa mundemi edhe ne, duke i pasur parasysh specifikat tona, të organizohemi si bashkësi e qytetarëve të Kosovës dhe përmes atij organizimi t'i realizojmë objektivat tona, çështjen e biznesit, ruajtjen e identitetit dhe të gjitha çështjet që janë të rëndësishme për ne si shtet dhe për diasporën atje.

Enver Hoxhaj, kërkoi të informohet nga ministri se a kanë arritur që ta studiojnë bazën legale në pushtet lokal e pushtet qendror të shteteve të ndryshme perëndimore, me qëllim që kjo bazë legale t'i sigurojë diasporës financim për mësim plotësues, dhe përveç bazës ligjore, a është menduar ndërlidhja me përfaqësues tanë politikë tanë atje. Kryetari pyeti se a ka ndonjë informatë se çfarë ndodh me shumë institucione në perëndim, sidomos në Zvicër, Gjermani, e Austri, të cilat njihen kohët e fundit si xhami, cili është roli i tyre në të ardhmen, cili është roli i Bashkësisë islame, çfarë do të bëjë shteti i Kosovës në këtë drejtim. Lidhur me regjistrimin e diasporës pyeti se cili është funksioni i këtyre të dhënave. Përkrahu qasjen e Ministrisë lidhur me qendrat kulturore që ato t'i shërbejnë diasporës për të prezantuar kulturën tonë, vlerat tona e identitetin tonë, si dhe pyeti se a mendohet që në të ardhmen këto qendra, mund të kenë një funksion të prezantimit të një kulture që është kulturë e shek. XXI.

Ismet Beqiri, theksoi se Ministria e Diasporës duhet përkrahur, ndërsa veprimet jashtë duhet të organizohen, të kanalizohen dhe të bëhen bashkë në kuptimin pozitiv të kryerjes së obligimeve tona, karshi diasporës.

Valon Murati, duke u ndërlidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e Komisionit, theksoi se nga diaspora ka kërkuar që të mos politizohen për çështjet që ndodhin në Kosovë, por të politizohen për të drejtat e tyre, aty ku janë. Në disa shtete tha se kemi potencial të jashtëzakonshëm të diasporës për t'u bërë pjesë vendimmarrëse në nivel lokal, por edhe në atë qendror dhe se duhet punuar që të kanalizohen drejt fuqizimit të tyre politik aty ku janë. Sa i përket regjistrimit, tha se kemi bërë analiza dhe mendojmë që ky proces mund të avancohet edhe tek metodologjia, edhe tek qasja ndaj publikut, edhe tek koha kur duhet të koncentrohet kampanja apo edhe për t'i shpërblyer ata me ndonjë kartë të diasporës, brenda mundësive të parapara ligjore.

Bëri të ditur se organizimi i diasporës duhet të trajtohet në të ardhmen dhe se në Kroaci ekziston një model i Kuvendit të diasporës, i cili është konsultativ, mbledhet një herë në vit dhe se një ide e tillë është menduar edhe tek ne, për përfaqësimin e diasporës. Metodën e mësimin të gjuhës shqipe tha se nuk kanë mundur të analizohen në të gjitha vendet, por shtetet skandinave kanë modele shumë të avancuara të mësimin të gjuhës shqipe. Sa i përket komuniteteve fetare, tha se do të bëhet përpjekje që ato të luajnë rolin e vet të arsimimit fetar dhe çdo pjesë e diasporës duhet ta luajë rolin për punën që e ka. Për çështjen e TV për diasporën, tha se i nevojitet mbështetja që të miratohet Ligji për mërgatën, në të cilin parashihet 6-8% e programit t'i dedikohet diasporës. Lidhur me çështjen e migrimit, tha se nuk mund të flasë ende për një strategji, por në këtë drejtim do të duhej të kishim një strategji ndërinstitucionale, nëse do të ndodhte kthimi i menjëhershëm i njerëzve tanë. Këta njerëz tha se janë njerëz tanë, kudo që janë, ndërsa diasporë janë ata të cilët kanë filluar të jetojnë atje.

Enver Hoxhaj, në mes tjerash, në diskutimin e tij propozoi që të organizohet një konferencë e veçantë e përbashkët, ku do të diskutoheshin të gjitha çështjet për diasporën, me ç'rast do të vihej në pah se çka Kuvendi mund të bëjë për diasporën dhe cilat do të ishin prioritetet për mbështetjen e saj.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9 shkurt 2015

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 9 shkurt 2015, me vërejtjet e deputetes Puhie Demaku, e cila tha se në procesverbal është dashur të ceket që Komisioni e ka miratuar si vendim në mbledhjen paraprake çështjen e punëtorisë dhe diskutimin për formimin e grupeve të miqësisë. Në pikën për formimin e grupeve të miqësisë, vërejtja e deputetes Demaku ishte: pavarësisht votimit të propozimit për formimin e grupeve të miqësisë, është dashur të përcillet në Kryesi edhe propozimi i saj.

4. Shqyrtimi i shkresës për formimin e grupeve të miqësisë

Lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, anëtarët e Komisionit Zafir Berisha e Elmi Reçica, duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë për bashkëpunim më të afërt me Mbretërinë e Bashkuar, vlerësuan të nevojshëm formimin e Grupit të Miqësisë, të veçantë me Mbretërinë e Bashkuar.

Kryetari i Komisionit propozoi që Komisioni ta mbajë edhe një takim për formimin e grupeve të miqësisë, ku në mënyrë më të hollësishme do të diskutohej çështja e formimit të tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj